

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATË PËR SHTYP

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR VITIN 2007

MARS 2008

ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR VITIN 2007

MARS 2008

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për vitin 2007 rezultoi me një tepricë prej 149 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit kanë përballuar me rreth 96 për qind nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Thellim i ndjeshëm i deficitit tregtar dhe atij korent, në krahasim me një vit më parë, si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).
- Zhvillime pozitive në tregtinë e shërbimeve.
- Rritje të flukseve hyrëse të kapitalit të huaj në formën e investimeve të huaja direkte.
- Rritje në stokun e rezervave valutore të autoritetit monetar.

I. LLOGARIA KORENTE

Viti 2007 është karakterizuar nga një aktivitet tepër intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të konsiderueshme si të shpenzimeve korente ashtu edhe të të ardhurave. Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me rreth 20 për qind krahasuar me vitin 2006 duke shënuar një nivel prej 8.3 miliardë eurosh, nga të cilat 60 për qind kanë shkuar për shpenzime.

Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Ndërkohë, 60 për qind e të ardhurave janë krijuar nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve, dhe pjesa tjetër ka ardhur në formën e transfertave korente (33 për qind), të ardhurave nga puna dhe nga investimet (7.4 për qind).

Deficiti korent për vitin 2007, u vlerësua në nivelin 878 milionë euro, me një rritje prej rreth 64 për qind kundrejt vitit 2006, duke qenë i barazvlefshëm me rreth 11 për qind të PBB-së.

Deficiti i lartë tregtar që ka karakterizuar zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjatë këtij viti, ka neutralizuar efektet pozitive të zvogëlimit të ndjeshëm të pozicionit deficit në llogarinë e shërbimeve si dhe rritjen e flukseve pozitive të të ardhurave faktoriale neto, duke mbetur shkaktari kryesor në thellimin e deficitit korent për këtë periudhë.

I. 1. TREGTIA E JASHTME¹

Fluksi i madh i shkëmbimeve tregtare që karakterizoi vitin 2007, rezultoi me një vëllim të përgjithshëm tregtar prej 3.8 miliardë eurosh, i vlerësuar

ky 26 për qind më i lartë se viti paraardhës. Kontributi i tregtisë së mallrave në llogarinë korente mbetet në nivele të larta, rreth 44 për qind e të gjitha transaksioneve korente gjatë vitit. Intensifikimi i aktivitetit tregtar ishte reflektim dhe i disa faktorëve të tjerë, si rritja e përgjithshme e çmimeve, luhatjet në kursin e këmbimit, si dhe ulja graduale e tarifave doganore, pjesë e proceseve liberalizuese tregtare.

Edhe pse dinamika e tregtisë na flet për ritme të larta rritëse si në importe (26 për qind) ashtu edhe në eksporte (25 për qind), baza e ulët e këtyre të fundit nuk mundi të ndikojë në përmirësimin e deficitit tregtar. Ai arriti vlerën e 2.3 miliardë eurove ose 27 për qind më i lartë se viti 2006.

Kapaciteti prodhues në vend, i pamjaftueshëm për të kënaqur kërkesën gjithmonë e në rritje të ekonomisë shqiptare për mallra, ka bërë që raporti i mbulimit të importeve nga eksportet të jetë në nivele të ulëta, 26 për qind.

Transaksionet e tregtisë së jashtme tregojnë për një përqendrim të theksuar drejt mallrave të ndërmjetëm, të cilët gjatë vitit 2007 përfaqësuan pjesën dërrmuese të importeve (53 për qind). Ndërkohë, mallrat e konsumit janë ulur me 7 pikë në nivel përfaqësimit, duke zënë 30 për qind të totalit të importeve. Rritja e ndjeshme prej 36 për qind e mallrave kapitalë, ka bërë që ata të përfaqësojnë 14 për qind të totalit të importeve gjatë vitit 2007.

Kushtet jo të favorshme klimaterike dhe kërkesa e lartë e ekonomisë në zhvillim, kanë sjellë 3.5-fishim të importit të energjisë elektrike, në krahasim me vitin paraardhës. Ndërkohë që në vlerë rezultoi 6 herë më i lartë, duke reflektuar kështu rritjen e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet botërore. Fluksi i lartë hyrës i makinerive dhe pajisjeve, që është vërejtur gjatë vitit 2007 (rritje prej 30 për qind), ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të sektorit ndërtues në vend si dhe e investimeve në infrastrukturë. Është e qartë që këta grupmallra rrisin konsumin e karburanteve, gjë që shpjegon dhe rritjen e shpenzimeve për import të lëndëve djegëse.

Në kahun e eksporteve shfaqen rritje të konsiderueshme pothuajse në të gjithë grupmallrat. Përmendim këtu produktet minerale, që u vlerësuan 3 herë më të larta se viti paraardhës. Kontributin më të madh në këtë rritje e dhanë eksportet e kromit me tregje të përqendruara drejt Kinës dhe Suedisë.

Grupmalli që shfaqti rritjen më të madhe gjatë vitit 2007 ishin lëndët djegëse (130 %). Eksportet e naftës së papërpunuar, të cilat përbëjnë dhe 72 për qind të këtij grupmalli, patën si destinacion kryesor fabrikat rafinuese në vendin fqinj, Itali.

Aktiviteti tregtar në sektorin e industrisë përpunuese edhe gjatë këtij viti, vazhdon të përbëjë pjesën dërrmuese të tregtisë së vendit tonë. Importet për lëndë të parë përfaqësuan 13 për qind të totalit, ndërkohë që 67 për qind e të ardhurave nga eksporti ishin rezultat i rieksperteve. Suficiti që karakterizon këtë industri prej vitësh, në vlerë absolute u vlerësua 120 milionë euro.

I. 2. ZHVILLIMET NË ZËRAT E TJERË TË LLOGARISË KORENTE.

Viti 2007 ka pasur zhvillime pozitive në tregtinë e shërbimeve. Pozicioni neto i shërbimeve, vlerësohet në 3 milionë euro, me një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin paraardhës (-67 milionë euro).

Gjatë këtij viti, të ardhurat nga eksporti i shërbimeve u rritën më shpejt se shpenzimet për importe shërbimesh, përkatësisht me 22 dhe 15 për qind kundrejt një viti më parë. Turizmi, në mënyrë konstante kryeson në gjenerimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, respektivisht me 69 dhe 64 për qind ndaj totalit. Prurjet nga eksporti në turizëm kanë arritur në nivelin 1 miliard euro, të vlerësuara 27 për qind më shumë, se ato nga eksporti i mallrave.

Rritja vjetore e të ardhurave nga turizmi vlerësohet në rreth 24 për qind. Kjo rritje është ndikuar, kryesisht nga rritja e numrit të shtetasve të huaj dhe të emigrantëve (62 për qind) që kanë vizituar vendin si edhe nga rritja e shpenzimeve ditore, ndërkohë që ditëqëndrimi mesatar vlerësohet në rënie të lehtë. Ndërkohë, shpenzimet e shqiptarëve në udhëtimet jashtë shtetit kanë arritur në rreth 923 milionë euro. Vëllimi i shpenzimeve për udhëtime, për vitin 2007, vlerësohet rreth 20 për qind më i lartë krahasuar me një vit më parë. Pasojë kjo, vetëm e rritjes së numrit të udhëtarëve me 48 për qind, ndërkohë që koeficientët vlerësues të kohëqëndrimit dhe të shpenzimeve mesatare ditore kanë pësuar një rënie të lehtë.

Gjatë këtij viti, vihet re një përmirësim i bilancit të tregtisë së shërbimeve në pothuaj të gjithë sektorët. Shqipëria vazhdon të jetë importuese neto e shërbimeve të transportit dhe të sigurimit të mallrave, fenomen ky që lidhet natyrshëm me rritjen e importeve të mallrave dhe që ndikon drejtpërdrejt në deficitin e tregtisë së shërbimeve. Ritme të shpejta zhvillimi vihen re edhe në shërbimet financiare, të komunikacionit dhe ato të biznesit, duke shfaqur potenciale konkurruese të vendit tonë në tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve.

Bilanci pozitiv i të ardhurave faktoriale në fund të vitit (216 milionë euro) vlerësohet me një rritje vjetore prej 4 për qind. Kjo rritje i dedikohet të ardhurave nga investimet e mjeteve tona jashtë, nëpërmjet interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar, në institucionet financiare jorezidente dhe ato në formën e investimeve të portofolit. Ndërkohë këtë vit, të ardhurat nga puna kanë pësuar një rënie prej 10 për qind.

Transferta korente si çdo vit marrin formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit, përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit në tregti mallrash dhe shërbimesh. Gjatë vitit 2007, janë vlerësuar në nivelin 947 milionë euro (me një rritje të lehtë vjetore prej 1.3 për qind) ose 12 për qind e PBB-së. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 44 për qind, me një rënie me 11 pikë përqindje kundrejt vitit të kaluar. Prurjet nga emigrantët janë shoqëruar edhe nga transfera të tjera private dhe shtetërore duke regjistruar 1 miliard euro transfera neto, për vitin 2007.

II. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Viti 2007 karakterizohet nga një lëvizje shumë e madhe e kapitalit në të dyja kahet, kryesisht në atë hyrës. Përfunduar transfertat e njëanshme të kapitalit, llogaria financiare këtë vit përkufizohet në rritje të madhe si të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën ashtu edhe të mjeteve tona jashtë. Viti regjistroi një fluks neto kapitalesh prej 836 milionë eurosh, duke mundur financimin e rreth 95 për qind të deficitit korent.

Transfertat kapitale, të cilat karakterizohen kryesisht nga grante me karakter investimi si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat, vlerësohen 90 milionë euro.

Në llogarinë financiare vihet re një rritje e madhe e detyrimeve tona valutore të përfaqësuara nga investimet e huaja direkte, huamarrja afatgjatë me terma të zbutur si dhe investime të tjera afatgjata dhe afatshkurtra. Këto të fundit përfaqësohen në formën e depozitave të vendosura në sistemin tonë bankar, nga institucione financiare jorezidente.

Këtë vit ekonomia shqiptare ka pritur flukse hyrëse të kapitaleve të huaja duke rritur detyrimet e saj me rreth 806 milionë euro. Kjo rritje vlerësohet rreth 45 qind kundrejt vitit 2006.

Fluksi i investimeve të huaja direkte gjatë vitit 2007 regjistroi 463 milionë euro, me një rritje vjetore prej 205 milionë eurosh kundrejt vitit të kaluar. Kjo rritje ka ardhur veçanërisht nga investimet në fushën e komunikacionit, rezultat kryesisht i procesit të privatizimit si dhe rritjes së pranisë së kapitalit të huaj në sektorin financiar të ekonomisë shqiptare. Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte janë shoqëruar me flukse të kapitalit në formën e huamarrjes, rreth 129 milionë euro. Nga të cilat, 93 për qind kanë shkuar në sektorin e qeverisë. Rritja e këtyre detyrimeve ka çuar në rritjen e pagesave të ardhshme të borxhit të jashtëm. Njëkohësisht, shërbimi i borxhit të jashtëm për vitin 2007 ka reduktuar detyrimet tona me rreth 54 milionë euro, duke përfaqësuar vetëm 7 për qind të eksporteve tona, gjë që tregon për një aftësi paguese brenda niveleve të pranuar. Ndërkohë, huamarrja private duket të ketë ngadalësuar ritmet e rritjes së saj. Krahasuar me vitin 2006, rritja e detyrimeve të këtij sektori vlerësohet sa 27 për qind e fluksit hyrës të një viti më parë dhe zë vetëm 7 për qind të huamarrjes.

Këtë vit, një rëndësi të veçantë kanë marrë detyrimet financiare të krijuara nga investimet afatshkurtra, në formën e rritjes së depozitave të jorezidentëve si edhe nga detyrime të tjera, të krijuara nga sektorët financiarë dhe ata jofinanciarë (250 milionë euro). Këto detyrime kanë qenë kryesisht në euro (66 për qind) dhe në dollarë (34 për qind). Vlen të përmendet, që kjo rritje ka ardhur edhe si rrjedhojë e vendosjes së depozitave të emigrantëve në sistemin tonë bankar, gjë që tregon rritje të interesit të emigrantëve për të investuar në ekonominë shqiptare.

Detyrimet në formën e kredisë tregtare u rritën me 11.8 milionë euro, e krijuar kjo nga rritja e importeve për këtë periudhë.

Flukset dalëse të kapitalit në formën e investimeve jashtë kanë rritur stokun e mjeteve tona jashtë me 57.4 milionë euro. Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë vlerësohen me rritje prej 55 milionë eurosh, duke dhënë kontributin kryesor në rritjen e mjeteve. Në përbërjen e tyre sipas monedhës, 57 për qind e zënë mjetet në dollarë, ndërsa pjesa tjetër është e vlerësuar në euro (36 për qind) dhe stërlina angleze (7 për qind). Rritja e këtyre mjeteve ka ardhur jo vetëm si pasojë e rritjes së depozitave të publikut në sistemin bankar, por është vënë re edhe një ndryshim i raportit të mjeteve të investimit. Sistemi bankar këtë vit ka preferuar zhvendosjen e mjeteve nga investime portofoli në depozita me jashtë. Mjetet financiare, në formën e investimeve të portofolit, kanë shënuar një rënie vjetore prej 18.5 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, investimet e portofolit gjatë këtij viti mbizotërohen nga ato në dollarë rreth 66 për qind, në euro 23 për qind dhe në stërlinën angleze 10 për qind.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 148.6 milionë euro. Stoku i rezervave valutore në fund të vitit 2006 shënoi nivelin 1.5 miliardë euro, duke qenë i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4 muaj importe mallra dhe shërbime.

Tabelë 1. Bilanci i pagesave (në milionë euro).

	2006	T-1	T-2	T-3	T-4	2007
Llogaria korente	(535.1)	(183.4)	(162.9)	(215.7)	(316.2)	(878.1)
Eksporti i mallrave	630.6	182.3	209.8	197.3	196.9	786.3
Importi i mallrave	(2,316.0)	(632.0)	(717.7)	(732.8)	(838.9)	(2,921.5)
Bilanci tregtar	(1,685.4)	(449.7)	(507.9)	(535.5)	(642.1)	(2,135.1)
Shërbimet: kredi	1,194.8	273.5	346.6	464.6	370.5	1,455.2
Shërbimet: debi	(1,261.5)	(303.5)	(336.7)	(456.0)	(356.1)	(1,452.4)
Të ardhurat: kredi	263.0	62.3	60.1	91.5	64.2	278.1
Të ardhurat: debi	(54.4)	(8.7)	(13.1)	(20.6)	(19.4)	(61.8)
Transferta private pashpërblim	966.0	226.1	276.6	223.3	251.8	977.8
Transferta shtetërore pashpërblim	42.5	16.6	11.6	17.0	14.9	60.1
Llogaria kapitale	143.4	26.9	16.5	21.8	24.9	90.1
Llogaria financiare	408.7	140.1	137.2	261.2	210.1	748.6
Investime direkte	250.3	88.5	52.9	220.1	90.9	452.4
Investime portofoli	27.2	18.5	0.0	(19.2)	19.2	18.5
Kapitale të tjera*	125.4	30.3	84.3	57.6	100.0	272.3
Gabime dhe harresa neto	189.5	30.9	32.2	67.8	57.1	188.0
Bilanci i përgjithshëm	206.6	14.5	23.1	135.1	(24.1)	148.6
Rezervat dhe zëra të lidhur me to						
Mjetet e rezervës	(206.6)	(14.5)	(23.1)	(135.1)	24.1	(148.6)
Përdorim huash e kredish nga FMN	5.8	2.8	-	2.7	-	5.5
Për t'u mbajtur në vëmendje						-
Ndryshimi total në rezerva	159.2	13.3	13.4	120.0	(47.7)	99.0
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimit	(47.9)	(1.2)	(9.6)	(15.1)	(23.6)	(49.5)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN.

Shënim

¹ Vlerat e llogaritura në tregtinë e mallrave i referohen vlerës c.i.f. për import dhe f.o.b për eksport.

